

KARTELE INFORMATIVE

AL115024

1. Emri i shërbimit	Trajtimi financiar, suplementar për minatorët/ naftëtarët/ metalurgët sipas ligjit 29/ 2019				
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar i punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.				
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Përftohet pension për shkak të profesionit ose shtesë mbi pensionin e pleqërisë ose invaliditetit				
4. A jam përfitues?	Përfituesit janë: a) pensionistët, të cilët kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; b) pensionistët, të cilët kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë"; c) punonjësit, të cilët kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë; ç) punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftës/jellës dhe gazsjellës; d) punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë dhe ndërmarrje, sipas përcaktimeve në krerët III, VIII e XII, të pasqyrës nr. 1, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave				
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?	
	Për pension për shkak të profesionit bazuar në ligji nr.29, datë 23.05.2019 :				
	1	Kërkesë për caktim pensioni sipas formularit të miratuar nga ISSH-ja	Aplikanti	Po	
	2	Fotokopje e dokumentit të identifikimit, i cili duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë dhe e nënshkruar nga vetë personi	Aplikanti	Po	
	3	Vërtetim të zyrës së Gjendjes Civile në rast të ndryshimit të gjeneraliteteve	Zyra e Gjendjes Civile	Po	
	4	Librezë pune e plotësuar në të gjitha rubrikat sipas llojit të punës	Institucionet ku ka qenë i punësuar aplikanti	Po	
	5	Vërtetim për bazën e vlerësuar për perudhat e punësimit nga data 01.01.1994 deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga puna ose vetë punësimi	Institucioni	Po	
	6	Vërtetim i posaçëm i konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira në profesionet e vështira, sipas përcaktimeve në ligjin nr.29/ 2019 dhe në VKM-NË NR.526 datë 20.12.1958 Për ndarjen e punëve në kategori për efekt të ndryshuar , i lëshuar nga ndërmarrja ku personi ka qenë i punësuar, kur subjekti është aktiv ose nga dokumentacioni arkivor i ISSH-së	Institucioni	Po	
	7	Vërtetim për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak (për burrat)	Ministria e Mbrojtjes	Po	
	8	Çdo dokument tjetër i lëshuar nga organizma shtetërore që konfirmon llojin dhe periudhën e punës	Aplikanti	Po	
Për shtesë mbi pensionin e pleqërisë ose mbi pensionin e invaliditetit :					
1	Kërkesë për përfitimin e shtesës mbi pension sipas formularit tip të miratuar nga ISSH-ja	Aplikanti	Po		
2	Fotokopje e dokumentit të identifikimit të identifikimit e cila duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë dhe e nënshkruar nga vetë personi	Aplikanti	Po		
3	Dokumentet e tjera të lëshuara nga organet shtetërore ose nga punëdhënësit që disponohen nga pensionistët kërkues që konsiderohen të domosdoshme për efekt të saktësimin të llojit të punës për përfitimin e shtesës mbi pension sipas dispozitave të ligjit nr.29/2019	Aplikanti	Po		
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari	
	Sporteli i ADISA; Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore (ALSSH)	Sporteli i ADISA: Tiranë, Krujë, Kavajë, Fier, Gjirokastrë, Maliq, Shkodër, Patos, Librazhd dhe Belsh; Në çdo qytet të Republikës së Shqipërisë, ku ju keni vendbanimin	Në të gjitha sportelet dhe qendrat ADISA Tiranë, Krujë, Kavajë, Fier, Gjirokastrë, Maliq, Shkodër, Patos, Librazhd dhe Belsh; Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore që gjenden në çdo qytet të Shqipërisë	ADISA: E hënë- E premte ora 08:00 -15:00; ALSSH:E hënë - e premte, ora 08:00- 14:00 E shtunë, ora 08:00- 11:00	
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online	
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë Shërbim pa pagesë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës	
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	Sipas përcaktimeve në ligjin nr 29/ 2019				
10. Çfarë përfitoj?	Librezë pensioni				
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	Në varësi të llojit të përfitimit; vlefshmëria mund të jetë pa afat ose i përcaktuar				
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E-albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>	
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)				
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në: E- albania:e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al ISSH web: www.issh.gov.al; kontakt@issh.gov.al Call Center: 11800		Orari Call Center: E hënë - e premte, ora 08:00- 19:00		
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input checked="" type="checkbox"/>	Web-i i Institucionit <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>	
	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al		<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	Ligji nr 29/ 2019 "Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji"				